



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

01.104/2-14073



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Raport

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Takimet

Bazuar në obligimet ligjore, Kryetari i Komunës, në bashkëpunim me ekzekutivin komunal ka mbajtur takime dhe ka hartuar raportin 6 mujor të punës, të cilin më pas e ka prezantuar edhe para qytetarëve në takimin publik të mbajtur me datë: 23.06.2023 (e premte) në sallën e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, duke filluar nga ora 14:00

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe rrjetin social në llogarinë e komunës face book.

-Me 09.06.2023, është publikuar njoftimi për mbajtjen e takimit publik: Për punën, të arriturat dhe sfidat gjatë vitit gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 si dhe zhvillimet aktuale.

Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike.

Publikimi në uebfaqe: Njoftimi:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2023/06/14073.pdf>

Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <https://konsultimet.rks-gov.net>

Me 22.06.2023, në facebookun e komunës, është publikuar rikujtimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik,

2.Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

-Me 23.06.2023, është mbajtur takimi publik me qytetarë, në këtë takim të pranishëm kanë qenë 34 qytetarë dhe janë dhënë edhe komentet.

Lajmi për mbajtjen e konsultimit publik është publikuar në këtë vegëzën <https://kk.rks-gov.net/kacanik/news/mbahet-takimi-i-pare-publik-me-qytetaret-per-punen-e-kryetarit-dhe-te-komunes-per-gjashtemujorin-e-pare-te-vitit-2023/>

, lajmi është publikuar edhe në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Komentet:

Selim Reka- U.D. Gjinnazi “ Skenderbeu” Kaçanik

Dëshiroj të kem disa informata rreth projektit të rrugës Kaçanik- Viti- Kërbliq, ku janë procedurat?

Kërkoj që punimet në Gjinnazin “ Skenderbeu” të kryhen gjatë kohës së pushimeve si dhe kërkoj që të vendoset një pasqyre (shenjë e komunikacionit) tek hyrja e gjinnazit(mbrapa objektit).

Poashtu kërkoj shtrirje të ujësjellësit edhe në lagjen 2 Korriku në rrugën “ Kjani Bela” si dhe kërkoj rregullimin e pjesës ku është vendosur tabela digjitale tek kalaja, sepse ka penguar trotuarin.

Shpat Bulica- kryetar i KVRL-së

A ka investime në fushën e rinisë si dhe më konkretisht në Shtëpinë e Kulturës?

Qëndrim Vogliqi-

Ju përgëzoj për punën, kërkoj që raportin herave tjera ta kemi më herët në mënyrë që të kemi materialin paraprakisht që do ta diskutojmë. Kam ankesë sepse nuk kam marrë asnjë përgjigje në kërkesat e mia që i kam percjellur në komunë. Kërkesat i kam vazhduar edhe këtë vit por që për të njëjtat nuk kam marrë përgjigje. Kërkoj të bëhet publikimi i projektit të parkingut nëntokësor para se të bëhet nënshkrimi i kontratës.

Kur pritet të filloj realizimin i projektit të ndriçimit publik?

Ibrahim Dalloshi-

Kur do të bëhet hapja e ambulantës në Doganaj?

Abedin Vishi- Arsimitar nga Shkolla Filllore “ Qamil Ilazi”

Ju përgëzoj për punën dhe aktivitetet e juaja, ndërsa mund të them se asnjëherë si tani nuk ka pasur një shikëputje aq të madhe nga niveli qendror me atë komunal.

Kërkoj që investimet në shkollën tonë të realizohen gjatë kohës së pushimeve.
Kërkoj që të rregullohet rruga nga varrezat e dëshmorëve së bashku me trotuarin.

Kadri Dardhishta-

Deri më tani janë realizuar shumë projekte, ndërsa kërkoj që të realizohet rruga “Kjani Bela”, te lagjja Fera është bërë muri mbrojtës, mungon asfaltimi i rrugës.

Azem Koraqi-

Kanali i ujitjes në Kovaqec, po i bën dëm një prone private, kërkoj që ky problem të rregullohet.

Hasip Saliu

Ju përgëzoj për punët e deritashme, por njëkohësisht e rrugët lokale nuk janë rregulluar, kemi shumë familje pa asfalt, ndërsa kërkoj që kompensimi i pronave të bëhet më me kujdes.

Pas mbledhjes së komenteve ekzekutivi komunal ka diskutuar dhe trajtuar kërkesat dhe pyetjet e qytetarëve me kujdes.

- 1- Për rrugën Kërbliq- Viti- Kaçanik, ndonëse është nënshkruar memorandumi tre palësh, Komuna e Kaçanikut nuk është kontaktuar asnjëherë, ndërsa neve jemi interesuar për të marrë informata nga ministria, por që deri më tani nuk janë realizuar punët në pjesën nga komuna jonë, ashtu sic janë planifikuar edhe me marrëveshjen e nënshkruar vite më parë. Ndërsa sa i përket kërkesës suaj pas trajtimit kemi vendosur që të gjitha punët në Gjimnaz do të mundohemi që ti kryejmë gjatë kohës sa janë në pushime nxënësit, ndërsa kërkesa për vendosjen e pasqyrës (shenjë komunikacioni), vlerësojmë se është një kërkesë e qëlluar dhe e njëjta do të vendoset në vendin e kërkuar. Punimet rreth tabelës digjitale ende nuk kanë përfunduar, andaj edhe hapësira e trotuarit do të lirohet.

- 2- Investime në Shtëpinë e Kulturës janë realizuar viteve të fundit, ndërsa po këtë vit parashihet ndërtimi i Muzeut të Qytetit, ndërsa përmes subvencioneve komunale janë përkrahur edhe këtë vit aktivitetet rinore.
- 3- Jemi në përfundim të procedurave të projektit për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, dhe sapo të përfundojnë procedurat e prokurimit ky projekt do të filloj së realizuari dhe do të intervenohet varësisht se ku janë paraqitur dëmtimet.
- 4- Punët në ndërtimin e ambulantes së re në Doganaj tashmë janë në fazën përfundimtare, dhe brenda vitit pritet hapja e kësaj ambulante.
- 5- Me nënshkrimin e kontratës për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, do të intervenohet edhe në rregullimin e trotuarit në këtë pjesë.
- 6- Përmes projektit të rregullimit të rrugëve lokale do të intervenohet edhe në rrugët në qytet dhe në disa rrugë lokale nëpër fshatra.
- 7- Do të shikohet mundësia e rregullimit të këtij problemi, pas trajtimit të problemit nga ana e zyrtarëve komunal nga sektori i bujqësisë dhe me ekspertë të kësaj lëmie.

Ylber Bajra
Shef i kabinetit

